



**PJESA B: KONTRATA**

**SHFMU"28 Nëntori" Brodosanë** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe  
**"Admir Salihu" B.I Brodosanë** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me material për mirëmbajtjen e disa shkollave të komunës së Dragashit ("28 Nëntori" Brodosanë, "Ullina" Kosavë, "Samidin Emini" Kuk, "Ilmi Bahtijari" Blaq dhe "Fetah Sylejmani" Dragash) me numër Identifikues : **621-22-min- 003 - 147**

**Neni 1 Lënda**

Furnizimi me material për mirëmbajtjen e disa shkollave të komunës së Dragashit ("28 Nëntori" Brodosanë, "Ullina" Kosavë, "Samidin Emini" Kuk, "Ilmi Bahtijari" Blaq dhe "Fetah Sylejmani" Dragash)

1.3 Afati kohor i pagesës nuk mund të jetë më shumë se **5 ditë** nga data e marrjes së urdhërës.

1.4 Vendi i ku do të bëhet furnizimi është: **SHFMU"28 Nëntori" Brodosanë "Ullina" Kosavë, "Samidin Emini" Kuk, "Ilmi Bahtijari" Blaq dhe "Fetah Sylejmani" Dragash**

1.5 Organi për : pranimin e mallit dhe përpilimin e proqesit është drejtori i shkollave përkatëse

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **985.50 €;**

**Me fjale: (Nëntëqind e tetëdhjetë e pesë euro e pesëdhjetë cent ).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bërës përkatëse).

**Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

**Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6                    Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *mallit* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## **Neni 7                    Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *mallit*.

## **Neni 8                    Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **të dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **furnizimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9                    Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10                  Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11                  Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12                  Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.



### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] <sup>1</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

|             |                                                                                     |             |                                                                                      |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|-------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | "Admir Salihu" B.I<br>Brodosanë                                                     | Emri:       | Ajet Reshiti                                                                         |
| Pozita:     | Drejtori                                                                            | Pozita:     | Drejtor i shkollës                                                                   |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 20.06.2022                                                                          | Data:       | 20.06.2022                                                                           |
| Vula:       |                                                                                     | Vula:       |  |